



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i së Drejtës në Fakultetin e Biznesit dhe të Drejtësisë, (FBD) shpall konkurs për 1 (një) pozicion pune, personel akademik me kohë të plotë, të kategorisë lektor:

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të kandidatit të kategorisë lektor janë si më poshtë:

I.1. Kriteret e përgjithshme të kategorisë lektor

1. Kandidati duhet të ketë gradën Doktor (lektor);
2. Grada e lëshuar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë i njohur dhe njëzuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri;
3. Kandidati të ketë përfunduar studimet universitare (Master i Shkencave dhe Bachelor) dhe ose ekuivalente me të, në fushën e drejtësisë;
4. Kandidati të zotërojë të paktën një nga pesë gjuhët e huaja të Bashkimit Europian;
5. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masa disiplinore të largimit nga puna;
6. Kandidati të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;

I. 2. Kriteret të veçanta për kandidatin e kategorisë lektor janë si më poshtë:

1. Fusha studimore e kandidatëve që do të pranohen duhet të jetë fusha e drejtësisë dhe më në veçanti profili i së drejtës publike, ndërkombëtare dhe evropiane;
2. Preferohen kandidatat me eksperiencë të mëparshme në mësimdhënie;
3. Preferohen kandidatë me eksperiencë (shkrimi, pjesëmarrje, drejtimi) në projektet kërkimore kombëtare, ndërkombëtare dhe evropiane;
4. Preferohen kandidatë të cilët kanë kontribut në zhvillimin dhe rishikimin e kurrikulave si dhe pjesëmarrje në proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit;
5. CV e vlerësuar në tërësinë e saj, përbën kriter preferencial;

Kandidatët duhet të dorëzojnë, pranë zyrës së protokollit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim (plotësim i formularit të aplikimit, i cili gjendet në faqen: www.uniel.edu.al).
2. Jetëshkrimi (CV).
3. Kopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave. Diplomat e lëshuara nga Institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht nga MAS.
4. Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

5. Kopje e librezës së punës/vërtetim punësimi nga punëdhënësi për ekperiencën e punës
6. Dëshmi e gjuhëve të huaja të noterizuar.
7. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti).
8. Raport i aftësisë për punë.
9. Fotokopje e letërnjoftimit.
10. Librezë shëndetsore.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** brenda 10 (dhjetë) ditëve (26.01.2026 – 04.02.2026) nga data e shpalljes në www.unie.edu.al në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim për pozicionin e punës: *personel akademik*,
Departamenti i së Drejtës - (FBD)
Elbasan**

Konkursi do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Biznesit dhe të Drejtësisë. Komisioni ad-hoc do të vlerësojë paraprakisht dosjet e kandidatëve dhe më pas kandidatët do ti nënshtrohen intervistës me gojë (09.02.2026 – 20.02.2026). Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit, orën dhe datën e intervistës dhe për shpalljen /njoftimi i fituesit.